

20181632975

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR
AVANCIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë merr hua te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore në shumë prej 28.700.000 euro, të dedikuar për realizimin e financimit të Projektit për avancim të shërbimeve sociale.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligjit, përcaktohen me Marrëveshje për hua për financimin e Projektit për avancimin e shërbimeve sociale, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor me shtrirje variabile.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për hua nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25% nga shuma e huas.

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim provizion në lartësi prej 0,25% nga pjesa e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 5

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".